



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Në bazë të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve me numër 01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, për subvencionet në fushën e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Komuna e Podujevës shpallë:

FTESË PUBLIKE

PËR APLIKIM NË PROJEKTIN:

FURNIZIMI ME MEKANIZËM BUJQËSOR

Përkrahja e fermerëve me:

Nr.	Lloji i mekanizmit bujqësor	Sasia/copë
1	<i>Mbjellëse pneumatike e misrit me plehrim 6 rendore</i>	2
2	<i>Mbjellëse e misrit mekanike me plehrim</i>	4
3	<i>Pllug rrotullues 4 rendor 12'</i>	3
4	<i>Freza 1.8m</i>	15
5	<i>Motokultivator me frezë</i>	16
6	<i>Makinë për shtrirjen e folisë plastike, sistemit pikë-pikë dhe mbjelljen e fidaneve të perimeve</i>	2
7	<i>Frezë për motokultivator 12HP</i>	100

Dokumentet e nevojshme për aplikim janë:

- 1. Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;*
- 2. Çertifikata e bashkësisë familjare;*
- 3. Vërtetimi i tatimit në pronë;*
- 4. Çertifikata mbi pronsinë e palujtshme, ndërsa në mungesë të saj kontrata mbi marrjen me qira të tokës me kohzgjatjen deri në 3 vite;*
- 5. Raporti i pagesave direkte/subvencioneve 2024;*
- 6. Çertifikata e regjistrimit të fermerit-NIF-i.*

Përparësit:

Poena

- | | |
|---|----|
| 1. Familjet (aplikuesit) të cilët nuk kanë përfituar në ndonjë projekt në 3 vitet e fundit; | 10 |
| 2. Numri i anëtarëve të familjes (për çdo anëtar 5 poena); | |
| 3. Përparësi të aplikimit kanë aplikuesit femra ; | 10 |
| 4. Aplikuesit në zonat e thella rurale ; | 10 |
| 5. Sipërfaqja e tokës së mbjellur (për çdo ha 1 pikë) | |

Kushtet për aplikim

- Të jetë banor i Komunës së Podujevës (kopja e letërnjoftimit);
- Të posedoj tokë të punueshme:
 1. Aplikuesit për *Mbjellëse pneumatike të misrit me plehrim 6 rendore*, të kenë së paku 20 ha tokë të mbjellur me misër;
 2. Aplikuesit për *Mbjellëse të misrit mekanike me plehrim*, të kenë së paku 10 ha të mbjellur me misër;
 3. Aplikuesit për *Pllug rrotullues 4 rendor 12'*, të kenë së paku 10 ha me tokë të punueshme;
 4. Aplikuesit për *Freza 1.8m*, të kenë mbi 5ha tokë të punueshme;
 5. Aplikuesit për *Motokultivator me frezë*, të kenë së paku 0.50 ha të mbjellura me perime, apo 0.20ha të mbjellura me pemë të imta;
 6. Aplikuesit për *Makinën për shtirjen e folis plastike, sistemit pikë-pikë dhe mbjelljen e fidaneve të perimeve*, të ketë së paku 10 ha të mbjellura me perime;
 7. Aplikuesit për *Frezë për motokultivator 12HP*, të kenë së paku 0.50 ha tokë të punueshme dhe të kenë Motokultivator 12 HP.
- Të jetë i/e regjistruar si fermer para datës së publikimit të thirrjes për aplikim;
- ❖ Fermerët përfitues do të marrin pjesë me 30% të vlerës së projektit;
- ❖ Komuna në cilësinë e subvencionuesit do të marrë pjesë me 70% të vlerës së projektit.

VËREJTJE: FERMERËT KANË TË DREJTË APLIKIMI VETËM NË NJËRËN NGA MEKANIZMAT E LARTËCEKUR !

Aplikacionet (kërkesat) dorëzohen në Zyrën e Shërbimit të Qytetarëve.

Afati i aplikimit është deri me datën 01.07.2024, ora 16:00.

Nr: 11-310/01-0037290/94

Podujevë

07 Qershor 2024



Drejtori i DBPZHR:

Lirie Hoti